Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Zyra e Drejtorit/ Kancelarija Direktora /Office of the Director

Numër: 02/519
Datë: 01.10.2018

Bazuar në nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 pika 3 me nën-pikën 3.2, nenin 26, 50 pikat 1,2 dhe 3 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe nenin 7 pika 2 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, kërkesës dt. 18.05.2018, si dhe në pamundësi të pranimit të stafit të rregullt, kryerjen e këtyre funksioneve në AKK, Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK) nxjerrë:

VENDIM

1. Marrëveshje për shërbime të veçanta të z. Arianit Fazliut në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, si ekspert i Teknologjisë Informative (IT), me qëllim të mirëmbajtjes, publikimit dhe të përditësimit të të dhënave në web-faqen e AKK-së.

2. Përgjegjësitë dhe detyrat e z. Fazliu gjatë periudhës së shërbimit në AKK:

   - Mirëmbajtja i linkut www.akk-ks.net, domein dhe hosting.
   - Publikimi i materialeve në tri gjuhë zyrtare të dërguara nga AKK sipas nevojës (24/7).
   - Publikimi i foto dhe video galerive.
   - Konvertimi i dokumenteve në PDF dhe publikimi i tyre online ne WEB faqe dhe rrjete sociale (facebook).
   - Trajnime për WEB për stafin e AKK sipa nevojës.
   - Kompaktibiliteti i WEB me broëser të ndryshëm, angazhimi në mirëmbajtje të kodit duke ruajtur këtë funksion.
   - Të bëjë arkivimin e databazës dhe fajllave fizik në baza mujore.
   - Ndryshimi i vegëzave dhe linqeve sipas nevojës

3. Z. Arianit Fazliu do të angazhohet për periudhën 3 mujore dhe pagesa do të bëhet 423.47 për një muaj.
4. Vendimi hynë në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke marrë parasysh që Ligji për Kualifikime Kombëtare detyron Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve që të hartoj, rregullojë dhe menaxhojë Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve si dhe me qëllim të përmbushjes së funksioneve të tjera që dalin nga ky ligj, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve konkludon si të domosdoshme angazhimin e programeri pasi që dokumentet e AKK duhet të behën publike dhe të modifikohen sipas nevojës me qëllim të transparencës dhe promovimit të aktiviteteve të saj për palët e interesit në nivelin kombëtar dhe atë ndërkombëtar.

Lah Nitaj
Drejtor i AKK

Vendimi u dërgohet:
1. Te emëruarit;
2. Divizionit të personelit;
3. Zyrës së Drejtorit të AKK;
4. Arkivit.